



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 804/2 Prot.

Tiranë, më 24.06.2025

V E N D I M

Nr.153, Datë 24.06. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 123 Regj, datë 23.05.2025, të paraqitur nga ankuesja znj. A.M kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *gjendjes arsimore* dhe *gjendjes shoqërore*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja A.M parashtron ndër të tjera se, është avokate dhe ka katër vite që paraqitet në Gjykatën e Tiranës (Dhoma Penale) për t’u aktivizuar në punë si avokate kryesisht, pranë kësaj gjykate. Sipas palës ankuese, punë ka shumë, por punën e marrin të njëjtët avokatë.

Ankuesja shpjegon se, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka nxjerrë një rregull, të cilin ia ka bërë me dije të gjithë gjykatave. Sipas rregullit të nxjerrë nga KLGJ, avokatët kryesisht duhet të aktivizohen mbi bazën e parimit të rotacionit. Ky rregull i KLGJ, jo vetëm që duhet zbatuar në vazhdim dhe nuk duhet të diskutohet më kjo mënyrë veprimi, por duhet të bëhet precedent. Pra, me ligj është rregulluar, por pavarësisht ankesave të përsëritura nuk është marrë asnjë masë ndaj gjyqtarëve. Për këtë shkak, gjyqtarët po abuzojnë, pikërisht sepse ndaj tyre nuk janë marrë masa. Ankuesja pretendon se ka gjyqe, por dyert e gjykatës hapen vetëm për sekserët, me të cilët ndajnë lekët.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Në lidhje me këtë problematikë ankuesja parashtron se i është drejtuar me një kërkesë për informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Juridiksioni i Përgjithshëm), nëpërmjet të cilës ka kërkuar që t'i vendoset në dispozicion një kopje e pasqyrës së shumës së fituar nga kolegët e saj, vetëm për 20 emra, sipas listës së avokatëve kryesisht që paraqiten për punë në gjykatë, por ky informacion nuk i është vendosur në dispozicion nga ana e Gjykatës.

Ankuesja deklaron se, ka kërkuar nga Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë (ILD) dhe KLGJ, që të veprojnë duke marrë masa ndaj gjyqtarëve të korruptuar, të cilët nuk pranojnë dhënien e të drejtës për punë. Sipas ankueses, nuk po merret asnjë masë ndaj këtyre zyrtarëve të korruptuar, të cilët nuk lejojnë njerëzit e shkolluar, si në rastin e ankueses, e cila është me dy universitete, grua, nënë me një fëmijë, që të gëzojë të drejtën për një hapësirë për punë në profesionin e saj dhe që i takon nivelit të saj të arsimimit, e kategorisë shoqërore, të cilës i përket, në mënyrë që të ushtrojë shërbimin në gjykatë si avokate kryesisht.

Ankuesja informon se, për këtë problematikë është në dijeni edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, por edhe masa e marrë nga ana e saj për caktimin e një “mbajtës liste” nuk funksionoi, sepse edhe ky i fundit është një nga përfituesit nga korrupsioni, për të cilin është ankuar vazhdimisht. Ndërkohë avokatët që nuk pranojnë t'i marrin kryesisht në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vite, duke i poshtëruar dhe vjedhur, padrejtësisht, gjyqtarët ndaj të cilëve ankuesja ka paratur ankesat e saj, në bashkëpunim edhe me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, i detyrojnë që të përfaqësojnë çështje në GJKKO, që janë pa pagesë. Jo vetëm që i marrin me detyrim në këto gjyqe, por insistojnë me qëllim që t'i përdorin vetëm ata, që sekserët e tyre të mos ju harxhohen orët e biznesit. Ankuesja deklaron se edhe është gjobitur me qëllim nga gjyqtarët sepse nuk ka pranuar përfaqësimin, pavarësisht se ka depozituar dokumentacionin justifikues lidhur me gjendjen e saj shëndetësore.

Ankuesja pretendon se ka kërkuar që të merren masa edhe ndaj sekretarëve të korruptuar, të cilët ndajnë lekët dhe marrin vetëm një grup sekserësh për gjyqe dhe që kanë një ndikim të paligjshëm, duke folur keq edhe tek gjyqtarët e rinj. Sipas ankueses me gjyqtarët e shkarkuar ose të dorëhequr duhet të hiqeshin edhe sekretaret e tyre. Ankuesja pretendon se nuk i ofrohet shërbim nga administrata e gjykatës, duke refuzuar që ti protokollojnë shkresat, por edhe duke u ofenduar në prani të të tretëve dhe duke krijuar debate të qëllimshme. Ankuesja pretendon se ka qenë subjekt i ofendimeve edhe nga ana e gjyqtarëve.

Nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja kërkon nga Komisioneri që të veprojë, duke reaguar dhe duke iu drejtuar mekanizmave që vënë në dukje diskriminimin e turpshëm në institucionin e drejtësisë, në të cilin paturpësisht, në kundërshtim me ligjin e çdo lloj morali njerëzor, e drejta e punës së një avokateje kryesisht, qytetare e këtij shteti, një grua, një nënë, ju shitet një grupi sekserësh, kriminelë dhe hajdutë, që janë familjarë të personelit të gjykatës, ish punonjës të gjykatës, kjo për qëllim që faturat e tyre të shkojnë me miliona në muaj, ndërsa ajo nuk merr as dyqind mijë lekë të vjetra në muaj. Kjo për arsye se diskriminohet padrejtësisht, duke mos e marrë në gjyq, pra duke mos e lejuar që të punojë, vetëm sepse nuk ka njohje dhe përkrahje dhe nuk ka ekonomi, por është një qytetare e thjeshtë që po përpiqet të mbijetojë me nder.

Ankuesja parashtroi se, korrupsioni vërtetohet me shumë për shpenzimet honorare, për avokatët kryesisht nga transaksionet e pasqyruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega e Thesarit Tiranë për 23 avokatë kryesisht.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri që të merren masa në lidhje me diskriminimin që po i bëhet nga administrata e gjykatës, të cilët të drejtën e saj për punë e kanë kthyer në biznes të familjarëve të personelit të gjykatës, duke filluar që nga gjyqtarët, prokurorët, sekretarët e deri te recepsionistët, policët dhe mirëmbajtësit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në parashttrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesi pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesja A.M , ushtron profesionin e avokates dhe është e pajisur me Linecë Nr. 11536, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ankuesja pretendon se, si pjesë e listës së avokatëve kryesisht në gjykatë, ajo diskriminohet pasi nga gjyqtarët nuk zbatohet parimi i rotacionit në caktimin e avokatëve kryesisht, por si të tillë nga gjyqtarët caktohen vetëm disa avokatë, të cilët sipas ankueses, caktohen mbi baza korruptive dhe janë sekserë ose familjarë të gjyqtarëve dhe sekretareve gjyqësore apo ish punonjës të gjykatës. Ankuesja gjithashtu pretendon se, nuk i ofrohen shërbime nga ana e punonjësve të caktuar të administratës së gjykatës dhe se ofendohet nga administrata, por edhe nga gjyqtarët.

Nga aktet e administruara rezulton se, me shkresën nr. 5970/2 prot datë 19.12.2022, KLGJ i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duke vendosur për dijeni edhe të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit, përfshi edhe Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke evidentuar nevojën e unifikimit të praktikës në lidhje me listat e avokatëve kryesisht që i vendoset në dispozicion gjykatave nga ana e Dhomave Vendore të Avokatisë, listë e cila në çdo rast duhet të bëhet bazuar në parimin e rotacionit. Ky komunikim i KLGJ, ka marrë shkas nga ankesa e një avokati kryesisht, i cili ka paraqitur pranë KLGJ problematikën lidhur me caktimin e avokatëve kryesisht në gjykata, ku sipas të cilit disa avokatë janë të preferuarit e gjyqtarëve dhe caktohen për të marrë pjesë në shumë procese gjyqësore në një ditë, kurse avokatët e tjerë kryesisht caktohen shumë pak.

Në lidhje me caktimin e avokatëve kryesisht, ankuesja i është drejtuar edhe KLGJ-së, e cila me shkresën nr.6149/1 prot., datë 24.12.2023, informon ankuesen në lidhje me shkresën nr. 5970/2 prot datë 19.12.2022, që KLGJ i ka dërguar Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duke theksuar njëkohësisht se: *“.....Këshilli i Kartë Gjyqësor nuk është institucioni kompetent që rregullon procesin e caktimit të avokatëve kryesisht. Për këtë arsye, ju bëjmë me vije se, Këshilli nuk ka miratuar asnjë akt nënligjor lidhur me çështjen konkrete, sepse është jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësisë së kompetencave të Këshillit të Kartë Gjyqësor, të rregulluar nga legjislacioni në fuqi.”*

Rezulton se, me vendimin nr. 359, datë 18.12.2024, të Komitetit Disiplinor pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ndaj ankueses është marrë masa disiplinore *“Pezullim i lejes së ushtrimit të profesionit për një periudhë 3 (tre) mujore”*, për shkelje të Kodit të Etikës së Avokatit.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 123, datë 23.05.2025, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe gjendjes shoqërore, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale.

- Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”*.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet³. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar

³ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁴. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm””⁵

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁶.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma (neni 3, LMD), ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2 LMD) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7, LMD).

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e

⁴ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁵ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

⁶ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se, shkakun i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Në lidhje me ekzistencën e shkaqeve të mbrojtura të pretenduara nga ankuesja, Komisioneri konstaton se, “*gjendja arsimore*” dhe “*gjendja shoqërore*”, janë shkaqe që gëzojnë mbrojtje nga neni 1, i LMD.

Gjendja arsimore, si shkak diskriminim, nënkupton nivelin individual të arsimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat në lidhje me arsimin, të cilat një person posedon.

Komisioneri vlerëson se, *gjendja shoqërore*, si shkak i ndaluar diskriminimi është një koncept i gjerë. *Shkakun i gjendjes shoqërore*, i referohet situatës aktuale të një personi në shoqëri ose të prezumimit të përkatësisë në një pozicion të caktuar shoqëror, në të cilën personi gjendet si pasojë e nivelit të të ardhurave, nivelit arsimor, aspekteve që kanë të bëjnë me përkatësinë në një profesion të caktuar, përfshi këtu edhe situatën e papunësisë. Ky shkak mbron kryesisht personat që janë të pafavorizuar për shkak të pozitës së tyre shoqërore, pozitë e cila shpesh, por jo vetëm, përcaktohet nga mjedisi socio-ekonomik dhe kulturor në të cilin jeton një person. Aspektet e mësipërme, për të vlerësuar gjendjen shoqërore të një personi, nuk janë shteruese apo kumulative, dhe se do të mjaftonte vetëm ekzistenca e vetëm njërit prej disavantazheve të mësipërme, në mënyrë që të provohet shkakun i gjendjes shoqërore.

Referuar parashtimeve të palas ankuese, Komisioneri konstaton se, shpjegimi që ankuesja bën në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit “*gjendja arsimore*” konsiston në faktin se, mosrespektimi i parimit të rotacionit në caktimin avokatëve kryesisht nga ana e gjyqtarëve, nuk e lejon ankuesen, e cila është e shkolluar dhe ka dy universitete, të gëzojë të drejtën për një hapësirë

për punë në profesionin e saj dhe që i takon nivelit të saj arsimor, në mënyrë që të ushtrojë shërbimin në gjykatë si avokate kryesisht.

Në lidhje me shkakun e diskriminimit “*gjendja shoqërore*”, bazuar në parashtrimet e bëra në ankesë, Komisioneri konstaton se, ky pretendim konsiston në faktin se, ajo është grua, nënë me një fëmijë, është një qytetare e thjeshtë dhe pa përkrahje. Në këtë kontekst, Komisioneri thekson se elementët e pretenduar nga ankuesja, nuk përfshihen në konceptin e gjendjes shoqërore, si shkak diskriminimi, por adresojnë pretendime që lidhjen me diskriminimin në bazë të gjinisë dhe gjendjes familjare.

Ndërsa ankuesja parashtron se mosrespektimi i parimit të rotacionit në caktimin e gjyqtarëve kryesisht nga ana e gjyqtarëve bëhet për motive korruptive, cenimi i të drejtës së pretenduar nga ana e saj për të ushtruar profesionin dhe për të ofruar shërbimet si avokate kryesisht nuk rezulton që të bazohet në gjendjes e saj arsimore apo në gjendjen e saj shoqërore. Caktimi ose jo si avokate kryesisht nuk kushtëzohet nga ndonjë aspekt që bazohet në arsimin e ankueses. Gjithashtu, nuk rezulton që caktimi si avokate kryesisht të kushtëzohet nga gjinia e saj, pra nga fakti që ankuesja është grua, krahasimisht me avokatët kryesisht të cilët janë burra, pra nuk konstatohen elementë të diferencës në trajtimin midis burrave dhe grave, apo nga gjendja familjare e ankueses, si nënë me një fëmijë, pavarësisht se në lidhje me këtë pretendim ankuesja nuk ka depozituar prova. Në këtë kuptim, shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja, nuk rezultojnë që të jenë shkaqe ose baza për trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj të cilit ankuesja pretendon se është ekspozuar, në lidhje me ushtrimin e shërbimeve si avokate kryesisht.

Sa më sipër, Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin e ankueses në lidhje me të dy shkaqet e pretenduara të diskriminimit “*gjendja arsimore*” dhe “*gjendja shoqërore*” dhe se nuk konstaton elementë të diferencës në trajtim për shkak të *gjinisë* apo *gjendjes familjare*.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ankuesja ka identifikuar në formularin e ankesës shkaqet e “*gjendjes arsimore*” dhe “*gjendjes shoqërore*”, Komisioneri konstaton se, pretendimet e paraqitura nga ana e saj nuk kanë të bëjnë me diferencë në trajtim ose dështim nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën, për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkaqet e pretenduara.

Komisioneri konstaton se, ankuesja nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se sjellja e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën, bazohet apo ka si shkak, gjendjen shoqërore dhe gjendjen arsimore, të cilat ankuesja i pretendon si shkaqe diskriminuese. Gjithashtu, kryesisht dhe duke u bazuar në parashtrimet dhe aktet e depozituara, Komisioneri nuk konstaton elementë të diferencës në trajtim për shkak të *gjinisë* dhe *gjendjes familjare*.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesja ka ngritur kundër institucionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, për sa kohë që, në mungesë të shkakut të mbrojtur/ndaluar të diskriminimit, ato nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja A.M , nuk mund të pranohet, pasi nuk përmbush kriteret ligjore dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 123 regj., datë 23.05.2025, të paraqitur nga znj. A.M , pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shoqërore, Gjendja arsimore
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim